


RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË DRENAS

PROJEKTET E MONITORUARA
“ASFALTIMI I RRUGËS LLAPUSHNIK-BERISHË-FAZA E DYTË”
“NDËRTIMI I KAPACITETIT TË UJËSJELLËSIT NË DRENAS-FAZA E DYTË”
“REHABILITIMI RRUGËS DHE NDËRTIMI I TROTUARIT NË ARLLAT-NEGROC-VUÇAK”
“INSTALIMI I PANELEVE SOLARE NË KULMIN E OBJEKIT TË KOMUNËS”





Nëntor 2025

Ky raport është përgatitur nga projekti DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo. Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË DRENAS

PROJEKTET E MONITORUARA

“ASFALTIMI I RRUGËS LLAPUSHNIK-BERISHË-FAZA E DYTË”

“NDËRTIMI I KAPACITETIT TË UJËSJELLËSIT NË DRENAS-FAZA E DYTË”

“REHABILITIMI RRUGËS DHE NDËRTIMI I TROTUARIT NË ARLLAT-NEGROC-VUÇAK”

“INSTALIMI I PANELEVE SOLARE NË KULMIN E OBJEKIT TË KOMUNËS”



DEMOS Decentralisation and Municipal Support

Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS) mbështet 38 komuna të Republikës së Kosovës në arritjen e qeverisjes lokale më demokratike dhe menaxhimit më të mirë komunal. Projekti DEMOS gjithashtu mbështet Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave, të cilat janë më të favorshme për financim të bazuar në rregulla për komunat. Projekti bashkëfinanohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, Qeveria Zvicerane dhe Qeveria Suedeze dhe zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovë. Mbështetja e DEMOS për komunat e Kosovës është në kuadër të Grantit të Performancës Komunale si njëri nga mjetet që garanton përkrahje për komunat me performancë të mirë.

Fokus i veçantë i projektit është edhe përkrahja për qeverinë qendrore ku DEMOS është i fokusuar në ofrimin e asistencës në ndërtimin e politikave për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar. Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të iniciojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (GPK) tek qytetarët. Projekti i DEMOS ka mbështetur edhe ndërtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që përfshijnë qytetarët në vendimarrje duke përfshirë ekipet e Auditimit Social të cilat kanë mbikëqyrur implementimin e projekteve të cilat janë financuar nga Granti i Performancës.

BIRN Kosova është një organizatë e pavarur, joqeveritare, qëllimet e së cilës janë informimi i qytetarëve dhe kontributi në procesin e tranzicionit demokratik në vend, promovimi i llogaridhënies, sundimi i ligjit dhe reforma e politikave. BIRN Kosova në veçanti synon të shërbejë si mbikëqyrës i institucioneve publike, duke monitoruar punën e institucioneve qeverisëse dhe publike. Përveç kësaj, përmes prodhimit të debateve televizive cilësore dhe të paanshme dhe trajnimit të të rinjve mbi aftësitë argumentuese dhe debatuese, BIRN synon të promovojë dhe inkurajojë një kulturë të debatit në Kosovë.

Vizioni i BIRN është të sigurojë pozicionin e saj si organizata kryesore e gazetarisë hulumtuese në Kosovë, duke adresuar nevojën për raportim objektiv, cilësor dhe të qëndrueshëm mbi sfidat e shumta të vendit. BIRN Kosova në partneritet me Demokraci Plus është angazhuar nga DEMOS për të bërë lehtësimin/fasilitimin e Auditimit Social në 16 projektet e përgjedhura në gjashtë komuna, Drenas, Lipjan, Istog, Dragash, Kaçanik dhe Mamushë.

Demokraci Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. D+ tenton integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet e tyre, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie. D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore. D+ ndërmerr iniciativa që kanë për qëllim afrimin e vendimmarrësve më afër qytetarëve përmes hulumtimeve të politikave, lehtësimit të dialogut apo komunikimit dhe edukimit publik.

Handikos Drenas është organizatë joqeveritare me përkushtim të thellë ndaj mbështetjes dhe fuqizimit të personave me aftësi të kufizuara.

Që nga themelimi i saj, organizata ka synuar të krijojë një shoqëri ku çdo individ, pavarësisht nga aftësitë fizike apo mendore, ka mundësi të barabarta për zhvillim personal, arsimim, punësim dhe integrim social.

Handikos Drenas ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe programesh që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara. Këto përfshijnë edukim dhe trajnime profesionale, aktivitete sociale dhe rekreative, mbështetje psikologjike dhe juridike, si dhe iniciativa për vetëpunësim dhe përfshirje në tregun e punës. Përmes këtyre aktiviteteve, organizata punon për të eliminuar barrierat sociale dhe fizike që pengojnë pjesëmarrjen e plotë të individëve në komunitet.

Vizioni i Handikos Drenas është një shoqëri gjithëpërfshirëse, ku diversiteti dhe aftësitë e ndryshme janë të vlerësuara dhe secili ka mundësi për t'u zhvilluar sipas potencialit të tij. Misioni i saj është të ofrojë mbështetje të vazhdueshme, të ndërtojë kapacitete të qëndrueshme dhe të krijojë mundësi reale për pjesëmarrje aktive në shoqëri për personat me aftësi të kufizuara.



PËRMBAJTJA

7	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE
8	GJETJET E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL GJATË PROCESIT
9	Gjetjet specifike në projektin “Asfaltimi i Rrugës Llapushnik - Berishë - Faza e dytë”
10	Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas - Faza e dytë”
10	Gjetjet specifike në projektin “Rehabilitimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc dhe Vuçak”
11	Gjetjet specifike në projektin “Instalimi i paneleve solare në kulmin e Komunës”
12	AMBIENTI NË TË CILIN ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL
14	KAPITULLI I - GJETJET E PËRBASHKËTA NË TË GJITHA PROJEKTET
19	KAPITULLI II - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN E “RRUGËS LLAPUSHNIK - BERISHË - FAZA E DYTË”
24	KAPITULLI III - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I KAPACITETIT TË UJËSJELLËSIT NË DRENAS - FAZA E DYTË”
28	KAPITULLI III - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI I RRUGËS DHE NDËRTIMI I TROTUARIT NË ARLLAT-NEGROC DHE VUÇAK”
32	KAPITULLI IV - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “INSTALIMI I PANELEVE SOLARE NË KULMIN E OBJEKIT TË KOMUNËS”
34	PËRFUNDIME / REKOMANDIME
36	Metodologjia
37	Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?
37	Si u grumbulluan të dhënat?
38	Validimi i të dhënave
38	Përbërja e ekipit
39	Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social
40	EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË DRENAS
41	LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË DRENAS
42	LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E DRENAS

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në tri vitet e fundit, Komuna e Drenasit ka mirëpritur dy iniciativa për themelimin e ekipeve të Auditimit Social. Në vitin 2025, në përputhje me metodologjinë e paracaktuar, BIRN dhe HANDIKOS Drenas lehtësuan procesin e themelimit të ekipit të “Auditimit Social” në Komunën e Drenasit. Brenda tre muajsh, ekipi u angazhua në mbikëqyrjen dhe analizimin e katër projekteve investive me vlerë të përgjithshme mbi 1.5 milion euro, duke përfshirë asfaltimin e rrugës Llapushnik-Berishë-faza e dytë, ndërtimin e kapacitetit të ujësjellësit në Drenas-faza e dytë, rehabilitimi e rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc-Vuçak, si dhe instalimi i paneleve solare në kulmin e objektit të Komunës.

Ekipi i Auditimit Social punoi në grupe të veçanta për monitorimin në terren dhe pas përfundimit të monitorimit të projekteve, zhvilloi konsultime të përbashkëta për evidentimin e gjetjeve të përgjithshme dhe specifike për secilin projekt. Nga monitorimi u identifikuan një sërë çështjesh kryesore lidhur me transparencën, cilësinë e punimeve dhe respektimin e afateve kohore. Bazuar në këto gjetje, u përgatitën rekomandime konkrete për komunën për përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe monitorimit të projekteve publike.

Komuna e Drenasit është një nga komunat përfituese të Grantit të Performancës Komunale. Për të rritur cilësinë e projekteve të financuara nga ky grant, një ekip aktivistësh të shoqërisë civile nga Drenasi, i mbështetur nga projekti DEMOS, nisi në gusht 2025 nismën e angazhimit qytetar në mbikëqyrjen e implementimit të projekteve publike.

Auditimi Social në Kosovë ka filluar të aplikohet nga DEMOS dhe organizatat e shoqërisë civile që nga viti 2022 dhe është zhvilluar më tej gjatë viteve 2023–2025. Me mbështetjen e projektit DEMOS dhe MAPL-së janë themeluar 35 grupe me më shumë se 700 qytetarë aktivë. Me mbi 700 anëtarë të përfshirë ndër vite, ekipet e Auditimit Social kanë ofruar mbi 200 rekomandime konkrete për përmirësimin e qeverisjes lokale dhe rritjen e transparencës institucionale.

Gjatë vitit 2025, BIRN dhe D+ së bashku me gjashtë organizata lokale — HANDIKOS Istog, HANDIKOS Kaçanik, HANDIKOS Drenas, OJQ Avoko, YAHR dhe MAMUŞA EMEKÇI KADINLAR DERNEĞİ me mbështetjen e DEMOS, themeluan gjashtë ekipe të Auditimit Social në komunat Dragash, Drenas, Lipjan, Mamushë, Kaçanik dhe Istog. Këto ekipe mbikëqyrën 16 projekte të komunave përfituese dhe u aftësuan përmes trajnimeve të specializuara në bazat e Auditimit Social, menaxhimin financiar dhe komunikimin strategjik.

Në Drenas, pas hulumtimit dhe konsultimeve me komunitetin, mbi 20 qytetarë u përzgjedhën për t’u bërë pjesë e ekipit të Auditimit Social. Trajnimet përfshinë ligjërime dhe praktikë në terren, duke përfshirë vendosjen e kontakteve me komunën, analizimin e dokumenteve dhe verifikimin e fakteve. Gjatë këtij procesi u kryen mbi 10 vizita në terren dhe mbi 10 takime zyrtare. Ekipi hartoi rekomandime konkrete, të cilat u ndanë me komunën dhe për të cilat Komuna e Drenasit u zotua për zbatimin e tyre.

Ky proces tregon rëndësinë e angazhimit qytetar në rritjen e transparencës, përmirësimin e menaxhimit të projekteve publike dhe fuqizimin e organizatave lokale në qeverisjen komunale.

GJETJET E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL GJATË PROCESIT



Në Komunën e Drenasit është vërejtur një përparim në zbatimin e standardeve të përcaktuara në Udhëzuesin Administrativ për Administratë të Hapur gjatë dëgjimeve buxhetore. Megjithatë, komuna duhet të angazhohet më tej për të rritur nivelin e pjesëmarrjes qytetare në këtë proces.



Në vendpunishtet ku është implementuar projekti nuk ka pasur udhëzime të qarta për implementimin dhe detajet e projektit, siç kërkohet në udhëzimin e MAPL-së për Administratë të Hapur të Komunave.



Projektet investive nuk janë diskutuar në publik me qytetarët në fazën e tyre të planifikimit.



Komuna dhe kompanitë implementuese nuk kanë ndërmarrë masa për të siguruar vendpunishten ku po zhvillohen punët.



Për projektin e ndërtimit të rrugës Arllat–Negroc–Vuçak, ende nuk është përfunduar procedura e nënshkrimit të kontratës, për shkak të ankesës së paraqitur në OSHP. Si pasojë, realizimi i projektit me kohë duket i rrezikuar, gjë që mund të ndikojë edhe në humbjen e mjeteve të planifikuara të grantit.



Për projektin e rrugës Arllat-Negroc-Vuçak, komuna nuk ka zhvilluar procedura të shpronësimit të cilat në disa zona janë të nevojshme për zgjerimin e trotuareve.



Gjetjet specifike në projektin “Asfaltimi i Rrugës Llapushnik - Berishë - Faza e dytë”

Gjatë vizitës në terren dhe takimeve specifike me zyrtarët e komunës, grupi i Auditimit Social ka konstatuar këto gjetje:



Projekti i ndërtimit të rrugës është hartuar pa një plan të qartë për mbrojtjen nga rrëshqitjet e dheut.



Zona ka rrezik nga erozioni i cili në këtë zonë është i lartë për shkak të pjerrtësisë.



Mungon tabela informuese dhe rrethojat në punishte.



Trajtimi i ujërave të shiut është bërë në distancë të papërshtatshme dhe rrezikon erozionin.



Asfalti i shtruar nuk është i nivelizuar sipas standardeve.



Rruga ende nuk është pajisur me sinjalistikë rrugore për zinxhirë dimri dhe kthesa të rrezikshme.












Në zonë janë disa lapidare të dëshmorëve të cilët nevojitet të kenë qasje në rrugë.



Rruga nuk ka mbrojtëse anësore me shirita ndriçues.









Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas - Faza e dytë”

	Planifikimi i shtrirjes së ujësjellësit ka marrë për bazë vetëm njësitë aktuale pa identifikuar planet e banorëve për investime në vitet e ardhshme.
	Në zonë mungojnë tabelat informuese me të dhënat e projektit.
	Në zonën ku janë zhvilluar punimet ka pasur mungesë të rrethojave në vendpunishte.
	Në disa zona projekti ka shkaktuar dëmtime të projekteve aktuale infrastrukturore.
	Mospërfshirja e hershme në planifikim dëmton investimet e ekzistuese.
	Në zonë identifikohet nevoja për investime shtesë për mbrojtjen e tubit të ujit nga rrjedhja e fuqishme e lumit (gypi mbrojtës).
	Dy lagje në fshatin Dobroshec janë jashtë sistemit të ujësjellësit, në mungesë të gypit kryesor.
	Në planifikim nuk janë parashikuar reduktuesit pas orës, qytetarët janë obliguar t’i vendosin vetë.
	Pastrimi i ambientit.

Gjetjet specifike në projektin “Rehabilitimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc dhe Vuçak”

Ekipi i Auditimit Social ka trajtuar edhe projektin e rehabilitimit të rrugës në Arllat. Projekti, i cili ende nuk ka filluar, është analizuar nga ekipi për t’u dhënë rekomandime fillestare të cilat përmirësojnë projektin dhe cilësinë e punimeve në të ardhme.

	Rruga është një investim në një projekt i cili në të kaluarën nuk ishte implementuar sipas standardeve dhe ka pësuar dëmtime.
	Projekti i rrugës ka paraparë intervenime në prona private që rrisin rrezikun për kontest pronësor, në ndërtimin e trotuarit.
	Në projekt është urgjencë që të projektohen intervenime në Urën e fshatit pasi rrezikohet nga vërshimi, nevojitet thellimi i saj.
	Në projekt duhet të planifikohet një vend-ndalim për autobus.
	Projekti i ri duhet të përmirësojë rrethojën e shkollës dhe paraqet pengesë për lëvizjen e nxënësve.
	Rruga e re duhet të ketë testimin e kapacitetit mbajtës dhe vendosjen e tabelës së tonazhit.

Gjetjet specifike në projektin “Instalimi i paneleve solare në kulmin e Komunës”

Instalimi i paneleve solare në kulmin e objektit të Komunës ishte nevojë dhe kriter që objektet instiucionale të jenë me këtë formë standarde të energjisë solare. Në periudhën kur ka nisur monitorimi i projektit, në fillim të muajit shtator 2025, për të njëjtin ende nuk ishte shpallur procedura tenderuese. Kontrata është nënshkruar më 14.10.2025 dhe ka filluar të implementohet disa ditë më vonë.

Ekipi i Auditimit Social gjatë punës ka listuar disa nga rekomandimet që do të vlenin për implementimin e këtij projekti. Për të njëjtat më pas i ka analizuar dokumentet dhe ka zhvilluar diskutime e takime me përfaqësuesit komunal.



Komuna ka respektuar monitorimin e kontratës



Komuna e ka vendosur panon informuese për projektin



Komuna ka ofruar dëshmi që tregojnë se punëtorët janë pajisur me mjete mbrojtëse



Nëpërmjet këtij investimi në objektin e komunës, pritet të ketë kursim deri 70% energji elektrike gjatë sezonit të verës



Komuna është në fazën finale të implementimit ka instaluar panelet dhe pritet pëlqimi për qasje në rrjetin energjetik



ÇKA DUHET TË DIJË NJË EKIP I AUDITIMIT SOCIAL?

Ekipe të Auditimit Social nuk nevojitet të jenë shkolluar profesionalisht. Ekipe të tilla kanë nevojë për vullnet dhe guxim qytetar; si dhe, rekomandohet të kenë njohuri bazike, në:

- Funksionimin e Komunës;
- Qasjen në dokumente publike;
- Procesin e konsultimit me publikun - sidomos gjatë planifikimit të buxhetit dhe investimeve në Komunë;
- Procesin e prokurimit publik.

AMBIENTI NË TË CILIN ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Komuna e Drenasit, me një popullsi prej 48 mijë e 79 banorësh, bën pjesë në grupin e komunave me madhësi mesatare në Kosovë.

Për nga numri i banorëve, të dhënat e regjistrimit të popullsisë REKOS2024 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës [ASK]¹, tregojnë se Drenasi është më i përafërt me Suharekën, duke u pasuar nga komunat: Malishevë, Rahovec, Skenderaj që numri i banorëve kalon 40 mijë banorë.

Komuna e Drenasit ka një buxhet prej 22,133,550 euro². Nga buxheti i përgjithshëm, 6,956,940 euro buxhet janë ndarë për investime kapitale që përbën 31.43% të buxhetit.

Për disa vite me radhë, Komuna e Drenasit ka arritur të renditet ndër përfitueset më të mëdha të Grantit për Performancë Komunale. Falë menaxhimit të mirë dhe rezultateve të arritura, komuna është vlerësuar lart. Drenasi ka përfituar mbi 1.5 milion euro për katër projekte nga ky grant të financuar nga projekti DEMOS dhe MAPL.

“Granti i performancës së komunave është një mbështetje financiare që u jepet komunave pas vlerësimit të performancës së tyre në menaxhimin e qeverisjes lokale. Granti në baza vjetore vlerëson mbi 100 indikatorë ku përfshihen transparenca, ofrimi i shërbimeve publike, planifikimi buxhetor dhe zbatimi i projekteve zhvillimore.”

Komuna zgjodhi projektin “Asfaltimi i Rrugës Llapushnik-Berishë-Faza e dytë” për t’i realizuar nëpërmjet Grantit të Performancës Komunale.

Projekti u shpall më 11.06.2025. Pas dy pezullimeve dhe një ankese të NNT “Korabi” në OSHP, ajo u tërhoq dhe u nënshkrua kontrata me Operatorin Ekonomik “DELTA–CCD” dhe “Valdrini” ShPK me vlerë 497,721 euro.

Projekti Llapushnik-Berishë-faza e dytë, përfshinë shtrimin dhe ngjeshjen e shtresave me gurë gëlqeror për stabilizimin e trasesë dhe anëve të rrugës, sipas kërkesave teknike për modulën e ngjeshjes. Mbistruktura përfshin asfaltimin me asfalt beton dhe sinjalizimin horizontal e vertikal, duke përfshirë vendosjen e tabelave dhe shënjimin me vija termoplastike të bardha.

Projekti tjetër është “Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas-Faza e dytë”. Tenderi u shpall më 30.05.2025. Kontrata u nënshkrua me Operatorin Ekonomik “Diamanti” ShPK në vlerë 497,721 euro.

Faza e dytë e ndërtimit të kapacitetit të ujësjellësit në Drenas, përfshin punët për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe realizimin e kyçjeve për konsumatorë. Punimet ndahen në disa faza: përgatitja e terrenit, gërmimet tokësore, vendosja e gypave të ujësjellësit, testimi dhe dezinfektimi i rrjetit. Këtu përfshihet vendosja e rërës e zhavorit, rehabilitimi i sipërfaqeve të dëmtuara

Përveç zgjerimit të rrjetit, parashihen edhe punime për realizimin e kyçjeve shtëpiake për konsumatorë, hapjen e kanaleve të vogla, vendosjen e gypave, montimin e pjesëve lidhëse dhe instalimin e pusetave me ujëmatës koncentrik dhe standarde.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës [ASK]_Regjistrimi i Popullsisë 2024: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/b45ea5db-09d5-4c97-9258-9d262cd8216f.pdf>

² Ligji NR. 08/L-260 Ligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>

Projekti për rehabilitimin e rrugës dhe ndërtimin e trotuarit në zonat Arllat-Negroc dhe Vuçak është shpallur më 19 qershor 2025 dhe është në procedurë tenderuese respektivisht ankesë. Gjatë procesit, aktiviteti u pezullua për shkak të kërkesës për rishqyrtim. Komuna vendosi më 1 shtator 2025 të rivlerësojë tenderin.

Pas rivlerësimit, Komuna e përzgjedhi Operatorin Ekonomik për kontratë, mirëpo, kundrejt vendimit të Autoritetit Kontraktues rasti shkoi në Organin Shqyrtues të Prokurimit, dhe është në procedurë. Ndonëse ende nuk ka një vendim të Panelit Shqyrtues, raporti i Ekspertit Shqyrtues i datës 13 tetor 2025, i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.³

Projekti parasheh instalimin e një sistemi solar fotovoltaik me kapacitet 55.68 kwp, duke përfshirë 96 panele monokristaline me efikasitet të lartë dhe një inverter trefazor 50 kw me pajisje për monitorim online. Përveç pajisjeve kryesore, përfshihet edhe infrastruktura mbështetëse si kabllot, lidhësit, strukturat metalike dhe mbrojtjet elektrike për pjesën AC dhe DC. Kontraktori po ashtu do të kryejë instalimin, testimin dhe komisionimin e sistemit sipas standardeve ndërkombëtare, si dhe do të merret me licensimin pranë KEDS. Ky projekt vlerësohet si i përfunduar pas dorëzimit të dokumentacionit teknik dhe trajnimit të stafit komunal për operim dhe mirëmbajtje të sistemit.



³ Organi Shqyrtues e Prokurimit [OSHP]_Raporti i Ekspertit_2025 0952_13.10.2025: <https://oshp.rks-gov.net/sq/Default/Home>

KAPITULLI I

GJETJET E PËRBASHKËTA NË TË GJITHA PROJEKTET

Nga analizimi i dokumentacionit dhe vizitave në terren të projekteve, ekipi i Auditimit Social identifikoi probleme që përfshinin fazën e planifikimit, procesin e kontraktimit dhe

zbatimin në terren, me sfida të tilla si vonesat, mungesa e cilësisë së duhur dhe nevoja për investimet të tjera.



Gjetjet në organizimin e dëgjimeve buxhetore

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me mbështetjen e projektit DEMOS në vitin 2023 ripërcaktoi normativën ligjore mbi të cilën komunat e vendit zhvillonin procesin e konsultimit me qytetarët.

Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna përcaktoi standarde të avancuara në të cilat komunat organizojnë konsultimet me qytetarët dhe i publikojnë të dhënat publike. Mbi këtë udhëzim komunat zhvillojnë takime me qytetarët me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të tyre në vendimmarrje. Sipas parimeve, Komuna konsulton qytetarët nëpërmjet:

- Takimeve publike;
- Konsultimeve publik për projektet dhe aktet normative dhe dokumenteve të politikave;
- Takime konsultative me qytetarë;
- Dëgjime buxhetore.

Ekipi i Auditimit Social gjatë programit të trajnimeve u pajis me njohuri për obligimet e autoriteteve lokale për të zhvilluar procesin e konsultimeve publike dhe mbi këto parime kontrolloi nëse Komuna e Drenasit kishte zbatuar standardet minimale të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur.

Ekipi analizoi dokumentet publike të komunës të cilat janë hartuar pas konsultimeve të zhvilluara nga komuna.

Viteve të fundit Komuna e Drenasit duket se ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar përfshirjen qytetarëve në procesin e konsultimeve publike, veçanërisht në hartimin dhe diskutimin e buxhetit.

Në këtë komunë e cila sipas regjistrimit të fundit të popullsisë ka 48,079 banorë; pjesëmarrja e qytetarëve është siguruar në dëgjime buxhetore, si në formë fizike ashtu edhe në mënyrë elektronike përmes email-it dhe kërkesave fizike të dorëzuara nga qytetarët gjatë procesit të konsultimeve. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ka ndihmuar në përfshirjen e nevojave reale të komunitetit në buxhet.

Komuna e Drenasit duket se i ka kushtuar rëndësi edhe përfshirjes gjinore. Sipas procesverbaleve të dëgjimeve buxhetore dhe përgjigjeve zyrtare të ofruara nga komuna, rezulton se Drenasi ka organizuar dëgjime buxhetore të dedikuara për gratë, duke përfshirë shoqatat e grave, gratë në biznes dhe organizata joqeveritare të udhëhequra nga gra. Këto takime kanë kontribuar në përfshirjen e barazisë gjinore në planifikimin e buxhetit komunal.

Gjatë vitit 2024, Komuna e Drenasit⁴ ka realizuar 9 dëgjime buxhetore për KAB, ku morën pjesë 386 qytetarë, prej tyre 201 burra apo 52.1% dhe 185 gra apo 47.9%.

4 Raporti Dëgjimeve_ <https://qlllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Raport-i-Konsultimeve-degjimeve-dhe-tubimeve-publike-per-periudhen-Janar-Dhjetor-2024-2.pdf>

Edhe në vitin 2025, raporti i dërgjimeve buxhetore bën të ditur se pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjimet buxhetore dominohet kryesisht nga burrat. Sipas këtij raporti, nga 327 qytetarë pjesëmarrës vetëm 92 ishin gra apo 28% ndërsa 72% ishin burra.

Për më tepër, komuna ka ndërmarrë veprime konkrete për të përmirësuar format e përfshirjes, përmes krijimit të një databaze të brendshme që ka shërbyer për të kontaktuar grupet e interesit dhe për t'i ftuar ata të marrin pjesë në dëgjime. Me mbështetjen e partnerëve si DEMOS dhe KDI, janë përdorur edhe mjete digjitale dhe materiale vizuale, si njoftimet përmes platformës CANVA, videot dhe storiet e suksesit, për të informuar dhe inkurajuar pjesëmarrjen qytetare në të gjitha fazat e procesit.

Kërkesat e qytetarëve të paraqitura gjatë konsultimeve janë trajtuar me kujdes dhe janë integruar në buxhetin e komunës. Në secilin proces të dëgjimeve publike, janë pranuar dhe analizuar kërkesat e ardhura nga qytetarët, të cilat më pas janë reflektuar në dokumentet planifikuese të komunës.

Procesi i dëgjimeve publike është zhvilluar duke respektuar të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative që rregullojnë këtë fushë, duke garantuar ligjshmëri dhe përputhje me standardet e qeverisjes së mirë.

Në aspektin e transparencës, të gjitha materialet e rëndësishme, duke përfshirë draft-buxhetin dhe listën e investimeve kapitale, u janë prezantuar pjesëmarrësve gjatë dëgjimeve dhe janë publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës dhe në rrjetet sociale zyrtare, duke siguruar qasje të barabartë dhe transparente për të gjithë qytetarët e interesuar.

Të gjitha raportet dhe procesverbalet për dëgjimet publike të mbajtura gjatë viteve 2023 dhe 2024 janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës, bashkë me dokumentet tjera relevante që mund të jenë me interes për qytetarët dhe palët e interesuara.

Ekipi i Auditimit Social e sheh të nevojshme që t'i kushtohet rëndësi zonave gjeografike ku mbahen dëgjimet buxhetore. Andaj, rekomandon që të rishikohet shpërndarja gjeografike e tyre në mënyrë që të përfshihen sa më mirë të gjitha zonat përkatëse.

Në dëgjimet buxhetore ekipi ka vërejtur mungesë e sqarimeve për banorët, çka ka kufizuar mundësinë e tyre për të dhënë komente apo propozime të informuara.

Gjatë dëgjimeve buxhetore është vërejtur se kërkesat e personave me aftësi të kufizuara duket se nuk janë trajtuar mjaftueshëm. Ekipi e sheh të rëndësishme që gjatë dëgjimeve buxhetore të merren parasysh kërkesat e grupeve të marginalizuara në mënyrë që procesi të jetë gjithëpërfshirës.

Ekipi i Auditimit Social ka pranuar përgjigje me shkrim nga Komuna e Drenasit ku thuhet se: "Projekti i parë "Asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishë" ka qenë kërkesë e bërë gjatë dëgjimeve buxhetore në zonën e Arllatit dhe Llapushnikut. Po ashtu, edhe projekti i "Ndërtimit të Kapacitetit të Ujësjiellit në Drenas", ka qenë kërkesë në secilin dëgjim buxhetor që kemi mbajtur. Ndërsa projekti "Rehabilitimit i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc dhe Vuçak", jo vetëm që ka dalë si kërkesë në dëgjimet buxhetore, por banorët e këtyre fshatrave kanë bërë edhe kërkesa me shkrim. Kurse projekti "Instalimi i paneleve solare në kulmin e objektit të Komunës" nuk ka qenë kërkesë në proceset e dëgjimeve buxhetore, por si nevojë dhe kriter që objektet instiucionale të jenë me këtë formë standarde të energjisë solare."⁵ Gjithashtu ekipi gjeti edhe procesverbale të takimeve për dëgjime buxhetore në këto fshatra.

⁵ Komuna e Drenasit_Përgjigje me shkrim_11.09.2025, dhe Procesverbale: <https://qlllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/20251006163454628.pdf>



Gjetjet në diskutimin e projekteve investive

Neni 17 i [Udhëzimit për Administratë të Hapur në Komuna](#) ka promovuar standardin që projektet investive të diskutohen me komunitetin në fazën e hershme të planifikimit të tyre. Mbi këtë standard, hartuesit e projekteve dhe komunat do t'i diskutonin projektet para nisjes së implementimit të tyre me qëllim që projektet të jenë të plota dhe të familjarizuara për tërë komunitetin.

Mbi këtë standard, para nisjes së procesit të prokurimit dhe gjatë fazës së hartimit të projektit, komunat do të organizonin takime me qytetarët për të prezantuar projektin, mjetet në dispozicion dhe ndikimin e tij në komunitetin lokal.

Tri nga katër projektet e përfshira në buxhet janë si rezultat i kërkesave të drejtpërdrejta të qytetarëve si: "Asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishë – Faza e dytë", "Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas – Faza e dytë", dhe "Rehabilitimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc dhe Vuçak".

Nga analiza e dokumenteve, komuniteti dhe përgjigjja zyrtare me shkrim nga Komuna e Drenasit, ekipi konstatoi se këto projekte janë kërkuar gjatë dëgjimeve buxhetore, ndërsa për projektin në Arllat-Negroc dhe Vuçak janë dorëzuar edhe kërkesa me shkrim nga banorët.

Në anën tjetër, projekti "Instalimi i panelave solare në kulmin e objektit të komunës" nuk ka qenë kërkesë direkte nga qytetarët, por është iniciuar nga komuna si pjesë e përpjekjeve për të përmbushur standardet për energji të ripërtëritshme dhe efikasitet energjetik në objektet publike.

Ekipi i Auditimit Social ka konstatuar se për katër projektet e mbikëqyrura në Drenas nuk janë zhvilluar takime të tilla formale me komunitetin.

Po ashtu, mund të thuhet që pasi është vendosur që këto projekte të realizohen, Komuna e Drenasit nuk ka mbajtur takim të veçantë me qytetarët enkas për t'i diskutuar konkretisht projektet dhe për të dëgjuar vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre në lidhje me to.

Neni 17

Format përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje

1. Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e:

1.1 Takimeve publike;

1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave;

1.3 Takime konsultative me qytetarë;

1.4 Dëgjime buxhetore.

2. Trajtimin e kërkesave peticioneve dhe kërkesave individuale e grupeve të qytetarëve.

3. Me qëllim të marrjes së pikëpamjeve të qytetarëve në procesin vendimarrës, komuna siguron zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik të përcaktuara në këtë udhëzim Administrativ.

4. Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale.

5. Ueb faqja e komunës dhe platforma qeveritare për konsultime publike do përdoren si platforma për realizimin e qëllimeve të këtij neni.

6. Zyra për Komunikim me Publikun, është përgjegjëse për njoftimin e qytetarëve për vendin, datën, kohën vendin, rendin e ditës, se kur do të mbahen takimet, degjimet buxhetore, konsultimet publike dhe takime tjera shtesë.



Gjetjet në zbatimin e obligimit për të njoftuar qytetarët

Gjatë monitorimit, ekipi ka konstatuar se kontratat janë të publikuara në E-prokurim, bashkë me disa informacione të tjera. Megjithatë, komuna nuk ka bërë transparente projektet ekzekutive dhe as dokumentet e tjera të rëndësishme si raporti i menaxherit të kontratës e faturat për punët e realizuara.

Ligji për Prokurimin Publik e bën transparencën parim bazë dhe kërkon që autoritetet kontraktuese të publikojnë dokumentet kryesore të procedurës së prokurimit, ndërsa për dokumentet e ekzekutimit të kontratës të sigurojnë qasje me kërkesë nga publiku. Kjo përfshin plane, specifikime dhe dokumente që lidhen me menaxhimin e kontratës, për sa këto nuk përmbajnë informata të klasifikuara si sekret tregtar. Në këtë kuadër, plani i menaxhimit të kontratës dhe dokumentet që lidhen me monitorimin e saj konsiderohen dokumente të qasshme ligjërisht.

Raportet e menaxherit të kontratës, vlerësimet e performancës dhe dokumentet operative të ekzekutimit nuk publikohen automatikisht, por

mund t'u jepen qytetarëve me kërkesë zyrtare, në pajtim me ligjin për qasje në dokumente publike. E njëjta vlen edhe për faturat dhe pagesat: edhe pse nuk publikohen në mënyrë të rregullt në platformën e prokurimit, ato janë pjesë e dokumenteve të ekzekutimit të kontratës që mund të kërkohen dhe shpërndahen, përveç kur përmbajnë informata të mbrojtura.

Andaj ekipi i Auditimi Social rekomandon që komuna të avancojë transparencën, duke publikuar në mënyrë proaktive edhe dokumentet ekzekutive të kontratave si projektet ekzekutive, përshkrimet teknike, raportet e menaxhimit dhe të dhënat kryesore mbi pagesat. Në praktikë, disa autoritete kontraktuese tashmë e kanë bërë këtë, duke publikuar projekte ekzekutive dhe dokumentacion teknik, çka ka rezultuar në rritjen e llogaridhënies dhe besimit publik. Kjo qasje do të ishte një praktikë e mirë edhe për komunën, pasi rrit dukshëm transparencën dhe ul hapësirën për keqinterpretime apo dyshime gjatë realizimit të kontratave publike.

Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna

Për çdo projekt, komuna vendos pano informuese për aktivitetin e prokurimit, në të cilën shkruhet emri i projektit, investitori, kompania implementuese dhe kohëzgjatja. Me qëllim të rritjes së transparencës, komuna duhet të vendosë emrin, mbiemrin dhe kontaktet e menaxherit, mbikëqyrësit apo kompanisë mbikëqyrëse të projektit.





Gjetjet në sigurinë e vendpunishtes

Ekipi i Auditimit Social, gjatë vizitave në terren ka konstatuar se Komuna e Drenasit nuk ka siguruar zbatimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë në disa vendpunishte publike nën përgjegjësinë e saj. Këto rregulla kërkohen nga Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në disa zonat ku janë zhvilluar punime në rrugë nuk janë vendosur shenja paralajmëruese apo sinjalizime për punimet në zhvillim. Po ashtu, nuk janë vendosur udhëzime apo paralajmërime për rreziqet potenciale. Po ashtu, punëtorët në vendpunishte u panë se nuk ishin të pajisur me të gjitha mjetet mbrojtëse [Helmëta, jelekë me shirita ndriçues, syze mbrojtëse për punë.

Konstatimi është edhe më i rëndësishëm duke pasur parasysh se ligji obligon kompanitë dhe organet përgjegjëse të ndërmarrin masa për të siguruar vendpunishtet, duke garantuar që ato të jenë të rrethuara, të kenë të vendosur shenja sinjalizuese dhe të ofrojnë udhëzime për qytetarët dhe punëtorët mbi rreziqet. Moszbatimi i këtij detyrimi ligjor rrit ndjeshëm rrezikun për aksidente dhe dëmtime fizike.

Mungesa e masave të sigurisë në vendpunishtet publike paraqet rrezik serioz për sigurinë e qytetarëve dhe punëtorëve. Zonat e pambrojtura dhe pa sinjalizim mund të shkaktojnë aksidente, rënie ose lëndime fizike, duke përfshirë dëmtime të mjeteve, dhe krijojnë rrezik për përgjegjësi ligjore dhe financiare për komunën, si dhe dëmtojnë reputacionin e institucionit për moszbatim të standardeve bazë të sigurisë dhe mbrojtjes në punë.



Gjetjet rreth qasjes për personat me aftësi të kufizuara

Për shkak se dy projektet kanë të bëjnë me rrugë, ato në tërësinë e tyre nuk kanë nevojë për përshtatje të larta për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, ekipi i Auditimit Social ka analizuar projektin e rrugës dhe trotuarit Arllat-Negroc-Vuçak, ekipi ka konstatuar se në zonë nuk ka parking për personat me aftësi të kufizuara, shteg të ecjes, duke përfshirë qasjen e personave me karroca.

Ekipi ka konstatuar se mungon parkingu i dedikuar për personat me aftësi të kufizuara, në parkingun ekzistues pranë shkollës “Jusuf Gërvalla” si dhe mungon një shteg i përshtatshëm për ecje që përfshin qasje të siguruar për përdoruesit e karrocave.

Ekipi i Auditimit Social ka identifikuar se projektet e ardhshme duhet të përfshijnë masa konkrete për të siguruar qasje universale, duke përfshirë:

- Parkingje të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara
- Pjerrina për qasje në trotuare
- Infrastruktura miqësore për përdoruesit e mjeteve ndihmëse të lëvizjes

Këto mangësi tregojnë mungesë të përfshirjes së grupeve me aftësi të kufizuara në projektim dhe implementim të infrastrukturës, duke rritur barrierat për qasje të qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe duke mosrespektuar parimet e dizajnit universal.

KAPITULLI II

GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN E “RRUGËS LLAPUSHNIK - BERISHË - FAZA E DYTË”

Projekti Llapushnik-Berishë-faza e dytë përfshinë shtrimin dhe ngjeshjen e shtresave me gurë gëlqeror [fraksione 0-150mm, 0-63mm dhe 0-31.5mm], për stabilizimin e trasesë dhe anëve të rrugës, sipas kërkesave teknike për modulën e ngjeshjes. Mbistruktura përfshin asfaltimin me asfalt beton AB16 [trashësi 8cm] dhe sinjalizimin horizontal e vertikal, duke përfshirë vendosjen e tabelave dhe shënjimin me vija termoplastike të bardha.

Para se të fillohej me ndërtimin e rrugës, Kushtrim Berisha, u emërua Menaxher i Kontratës. Në cilësinë e menaxherit ai i ka pranuar me kohë të gjitha dokumentet e nevojshme nga Zyra e Prokurimit. Është hartuar plani i menaxhimit të kontratës, duket se nuk ka pasur as ankesa, dhe procesi ka shkuar mirë.

Në projektin e “Asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishë - Faza e dytë”, ekipi i Auditimit Social ka konstatuar edhe probleme specifike të cilat lidhen me këtë projekt.



Mungon tabela informuese dhe rrethoja në vendpunishte

Ekipi vizitoi vendin ku po zhvillohen punimet, për të parë nga afër progresin e punimeve. Ekipi gjatë vizitave ka identifikuar se mungon tabela informuese në vendpunishte me të dhënat rreth projektit [emri i projektit, investori, punëkryesi...etj]. Ekipi vlerëson që në fillim të rrugës duhet të vendoset një shenjë për punime në rrugës, përfshirë kufizimin e shpejtësisë. Ekipi gjatë vizitave ka konstatuar po ashtu se në zonë mungojnë rrethojat e sigurisë së vendpunishtes.

Në rastet kur Operatori Ekonomik nuk e ka në pozicion vendosjen e tabelës, nuk është i obliguar ta vendos, mirëpo në shenjë mirëkuptimi pritët ta vendos. “Secila punë fillon, njëherë një paramasë, tani del në fazë të tenderimit. Në momentin e parë që në paramasë nuk e ka një kompani të specifikume tabelën informuese, nuk është e obligume

me vendos. Kontrata është publike, mundeni me pa. Përkundër kësaj kompania ka hasur në mirëkuptim me mu edhe e kemi përgatitë tabelën pa më thanë ju hiç, dhe tabela besoj vendoset për me mbetë gjithë aty. Ne e kemi dizajnu, dhe deri në fund të javës ajo vetëm se vendoset.”⁶

Në përgjigjen me shkrim të Menaxherit të Kontratës, Kushtrim Berisha, thuhet se është paraparë me paramasë. “Tabela informuese për projektin në fjalë nuk ka qenë as në paramasë e as nuk mundemi të obligohet një OE të vendos nëse nuk ka diçka te kontraktuar.”⁷

6 Takimi i ekipit të Auditimit Social me Menaxheri e Kontratë_Kushtrim Berisha_24.09.2025

7 Kushtrim Berisha_ përgjigje me shkrim_30.10.2025



Vendosja në distanca të theksuara e tubave kullues

Ekipi gjatë vizitës ka vërejtur që tubat kullues që qarkullojnë ujin nga njëra anë e rrugës në anën tjetër janë vendosur në distancë të largët dhe rekomandohet vendosja më e shpeshtë e tyre.

Rekomandim i mirë u vlerësua nga Afrim Prokshi, Koordinator i Grantit të Performancës nga ana e Komunës së Drenas, Shef i sektorit në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë. “Këta gypat mund të jetë një

rekomandim i mirë për shkak të konfiguracionit, gypat mundësojnë që rrjedhja të mos grumbullohet në një pjesë të rrugës pastaj, mundet edhe me prishë”⁸

Ekipi po ashtu e sheh të nevojshme ndërtimin e kanalit kullues dhe ndërtimin e disa qasjeve, për t’u mundësuar pronarëve qasje te pronat e tyre. Kjo shihet si problematikë nga menaxheri i kontratës nëse nuk ndërtohet fillimisht kanali.




Erozioni i kanalit anësor, nevojitet pritëse betoni

Ekipi gjatë vizitës ka vërejtur se për shkak të pjerrtësisë, kanali anësor është duke u gërryer nga erozioni. Ekipi rekomandon që të intervenohet me vendosjen e pritëseve nga betoni, të cilat do ta parandalon erozionin e mëtutjeshëm të kanalit.

Sipas Menaxherit, për shkak të kushteve të këqija ka pasur rrëshqitje të dheut dhe

është dëmtuar një pjesë e rrugës. Ndërsa, në mungesë të buxhetit, nuk ka qenë e mundur të ndërtohet një mur mbrojtës, edhe pse është shumë i domosdoshëm. Ai shton se vitin e ardhshëm, me gjasë kur të shpallet fitues i Grantit të Performancës dhe të kenë mjete në dispozicion, muri mbrojtës do të jetë investimi i parë që do të bëhet atje.⁹



Pastrimi i kanalit për kullimin e ujit

Gjatë vizitës në terren, ekipi i Auditimit Social ka evidentuar se disa gypa të kanalit të kullimit ishin pothuajse të bllokuar si pasojë e rrëshqitjes së dheut. Në këtë gjendje, me rritjen e sasisë së reshjeve, ekziston rreziku i qartë që uji të dalë mbi asfalt, duke shkaktuar dëmtime në shtresën e asfaltit dhe, rrjedhimisht, në gjithë investimin e bërë.

Prandaj, ekipi e konsideron të domosdoshëm pastrimin e kanalit dhe lirimimin e gypave për të shmangur dëmtimet e mëtejshme.

Rreth kësaj pike, Menaxheri i projektit, Kushtrim Berisha tha se ende nuk i kanë përfunduar investimet në atë rrugë dhe duhet edhe faza të tjera që të bëhet përfundimi i plotë të rrugës.

⁸ Takimi me Drejtorin e Shërbimeve Publike Z. Nexhmedin Gruda, Koordinatorin nga ekipi komunal për Grantin e Performancës, Shef i sektorit në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë Z.Afrim Prokshi, Menaxherin e Kontratës së Projektit të Ujësjellësit Znj.Diellza Bajraktari_14.10.2025

⁹ Takimi i ekipit të Auditimit Social me Menaxherin e Kontratës_Kushtrim Berisha_24.09.2025



Largimi i mbetjeve ndërtimore nga punëkryesi

Ekipi gjithashtu ka vërejtur se gjatë punimeve në zonë kanë mbetur mbetje ndërtimi, si asfalt, gurë, zhavorr, të cilat duhet të largohen nga

zona. Largimi i menjëhershëm i tyre është i dosmodoshëm për të parandaluar ndotjen e mjedisit.



Cilësia e dobët e punimeve ka shkaktuar deformim të asfaltit në disa pjesë

Nga vizita në terren, ekipi konstatoi se asfalti i shtruar ka filluar të deformohet në mënyrë të dukshme. Duke qenë se rruga është e ngushtë, me një gjerësi prej 5 metrash, kjo situatë krijon vështirësi, sidomos gjatë sezonit të dimrit. Andaj, për shkak të cilësisë së dobët të punimeve, duhet të merren masa të nevojshme.

Gjithashtu nevojitet të bëhet testimi trashësisë dhe i cilësisë së asfaltit.

Vijat e bardha në asfalt janë zbehur dhe kanë filluar të shlyhen, prandaj ekipi rekomandon që të ndërhyhet dhe të rregullohen ato.



Sinjalistikë rrugore për zinxhirë dimri dhe kthesa të rrezikshme

Edhe pse komuna e ka paraparë në planin e masave vendosjen e sinjalistikës rrugore, në paramasë nuk ka dhënë informacion shtesë për to. Andaj, në kuadër të sinjalistikës rrugore, ekipi e sheh të nevojshme vendosjen e shenjave që obligojnë pjesëmarrësit në komunikacion, të vendosin zinxhirë në automjete gjatë sezonit të dimrit, si dhe shenja për rrezikun e kthesave të rrezikshme dhe shenja të tjera për rrugë.

Për shenjat e trafikut, Menaxheri i projektit, Kushtrim Berisha¹⁰ tha se janë vendosur sipas ekspertit të komunikacionit dhe për rrethoja nuk ka pasur nevojë duke e ditur se ku janë duke investuar e që nuk ka pasur asnjë rrezik për komunitetin.

¹⁰ Menaxheri i projektit, Kushtrim Berisha_ përgjigje me shkrim_30.10.2025



Vendosja e vijzimeve me efekt dridhës në rrugë

Për shkak të lartësisë dhe pjerrësisë së terrenit në njërin anë dhe reshjeve të mundshme nga ana tjetër, ekipi ka konstatuar se është e nevojshme vendosja e vijave

të bardha me teksturë dridhëse, të cilat obligojnë pjesëmarrësit në komunikacion të ngadalësojnë shpejtësinë dhe të shmangin aksidentet.



Rrugë me potencial turistik, nevojitet tabela që parandalon hedhjen e mbeturinave

Rruga “Llapushnik-Berishë” ka një rëndësi të veçantë, sepse jo vetëm që lidhë fshatrat, por gjithashtu krijon mundësi për zhvillimin e turizmit duke përmirësuar lidhjen midis komunave Drenas dhe Malishevë. Për shkak të terrenit, është e nevojshme vendosja e tabelës që ndalon hedhjen e mbeturinave dhe materialeve inerte.

Ndërsa rreth mbeturinave dhe të tjerave, menaxheri Berisha është përgjigjur se ende janë duke përfunduar punimet në kontratën e lartecekur dhe në momentin e pranimit teknik të punimeve gjithçka do të jetë si duhet.



Përmirësimi i qasjes të lapidarët e dëshmorëve

Gjatë vizitave në terren, ekipi ka vërejtur gjithashtu se në skaj të rrugës janë të vendosur lapidarë të dëshmorëve. Ekipi i ka rekomanduar Komunës por edhe menaxherit që të ndërhyjë duke shtruar zhavorr në këtë zonë dhe të krijojë qasje më të lehtë për vizitorët. Në vizitën pasuese të ekipit, është evidentuar se disa qasje madje ishin asfaltuar.

Një intervenim të tillë ekipi e sheh të nevojshme edhe te lapidarët e tjerë që kanë qasje në këtë rrugë. Menaxheri thotë se dy lapidarët janë përfshirë në asfalt sipas sugjerimeve të tij, dhe guri i gradinës, si monument i vjetër, do të vendoset në zhavorr; tash mundësitë janë më të mira dhe vetëm një Greder do të mjaftojë për ta realizuar.

Kjo është evidentuar më pas edhe më nga vizita e ekipit në teren. Në anën tjetër, nga Komuna thonë se të gjithë lapidarët janë

në kompetencë të Agjencisë së Menaxhimit të Memorialeve. Komuna ka treguar se kjo Agjenci e ka përkujdesjen ndaj tyre dhe se është marrë një pëlqim nga ana e tyre. Mirëpo nuk do të thotë që edhe komuna nuk do të ndikojë në atë zonë.

Për çështje të lapidarëve, do të angazhohet një ekip tjetër në fazat e mëvonshme, do të merren parasysh dhe do të shikohet mundësia buxhetore.¹¹

Në përgjigjen që ekipi i Auditimi Social ka pranuar nga Komuna e Drenasit, përkatësisht Menaxheri i Kontratës, Kushtrim Berisha, thuhet se ka ndërmarrë veprime për këtë çështje dhe e ka adresuar rekomandimin. “Për Lapidarët e dëshmorëve ku ka pasur, ne kemi bërë zgjerimin edhe me asfalt e jo vetëm në zhavorr.”¹²

¹¹ Afrim Prokshi_Koordinator i Grantit të Performancës nga ana e Komunës së Drenasit_Afrim Prokshi_Shef i sektorit_Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë_14.10.2025

¹² Kushtrim Berisha_përgjigje me shkrim_30.10.2025



Tabela informuese për biodiversitetin e zonës

Ekipi ka konstatuar se është e nevojshme që komuna të angazhojë ekspertë për të bërë vlerësimin e botës së gjallë dhe bimësisë

në këtë zonë, si dhe të vendosë një tabelë informuese që u ofron vizitorëve të dhëna rreth karakteristikave natyrore të saj.



Vendosja e mbrojtësve anësore me shirita ndriçues

Për shkak të terrenit malor, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit kur shtohen reshjet, ekipi e sheh të nevojshme vendosjen e mbrojtësve anësore të rrugës. Kjo është parë si një mundësi e mirë edhe nga Menaxheri i Kontratës që ta aplikojnë në të ardhmen, pasi me kontratën ekzistuese nuk është përcaktuar. “Ndërsa për pjesën metalike mundemi me marrë si këshillë nga ana e juaj, me parapa për projektin tjetër, përndryshe në këtë fazë në paramasë nuk është.”


Deri në momentin e vendosjes së rrethojës, ekipi propozoi edhe vendosjen e shenjave vezulluese nga një metër, të vendosura në dy anët e rrugës. Menaxheri tha se mund t’i vendosim: ‘I kemi, mund t’i vendosim. Në bazë të paramasës kemi 15 shenja, dhe do t’i racionalizojmë në vendosje. Edhe nëse nuk mund t’i vendosim vetë, me shërbimet komunale ka kontratë për shenja; i çojnë ata, ne ua themi dhe ata i vendosin.

KAPITULLI III

GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I KAPACITETIT TË UJËSJELLËSIT NË DRENAS - FAZA E DYTË”

Dokumentet për menaxhimin e projektit si kontrata dhe dokumentet e tjera përcjellëse u janë dorëzuar me kohë Menaxheres së Projektit. Plani i menaxhimit të kontratës është hartuar dhe në të njëjtën kohë është pranuar nga operatori ekonomik.

Në anën tjetër sfidë mbeten pronat kontestuese dhe instalimet nëntokësore ekzistuese. “Sfidë mbetet pjesa e qytetarëve që kanë probleme me prona, ku hasim raste kur nuk mundemi ta implementojmë drejtpërdrejt gypin në pronën e tyre, ose ndodh që kanë rrjete të skemës elektrike nëntokë apo kanalizime. Duhet bërë revidim i projektit për t’i shmangur këto defekte.”¹³



Mungon rrethimi i vendpunishtes

Te projekti i ujësjellësit, Menaxherja e Kontratës e konfirmon se tabela informuese ishte vendosur, mirëpo është dëmtuar. Vendosjen e saj dhe gjendjen në të cilën ndodhej e ka evidentuar edhe ekipi i Auditimit Social gjatë vizitës në terren. Sipas kontratës, vendosja e tabelës ishte caktuar me një çmim 1,200 euro.

Në përgjigjen me shkrim të datës 11.11.2025, menaxherja e kontratës, Diellza Barjaktari, ka thënë se është dëmtuar nga persona të pandërgjegjshëm. “Tabela ka qenë e vendosur në zona, por personat e paidentifikuar të lagjes e kanë dëmtuar atë. Si pasojë e dëmtimit, ka qenë e nevojshme të vendoset përsëri për informim të banorëve”¹⁴.

Vështirësia më e madhe përmendet edhe ajo e lejeve nga “Iber-Lepenci”, në pjesët ku kalojnë gypat e tyre në ara, si dhe në segmentin e autostradës që është në kompetencë të Ministrisë.

Kjo është një sfidë pak më e madhe, e cila rrezikon të vonojë projektin. Menaxherja e projektit, Diellza Bajraktari tregon se aktualisht punimet po zhvillohen në Korreticë të Epërme, në segmentin ku gypi kalon nën autostradë. Ajo shton se kjo pjesë është më e vështirë për realizim dhe ndoshta do të jetë e nevojshme që projekti të ndalet përkohësisht deri në marrjen e lejes nga Ministria.

Ekipi në teren gjeti se vendpunishtja nuk ishte rrethuar. Rrethimi i vendpunishtes është i domosdoshëm, me qëllim që të kufizohet hyrja e personave të paautorizuar dhe të parandalohet rrezikshmëria e mundshme për kalimtarët gjatë fazës së punimeve. Një masë e tillë siguron mbrojtjen e qytetarëve dhe mbarëvajtjen e sigurtë të punimeve.

Për mungesën e rrethojave, Menaxherja e Kontratës ka dhënë këtë arsye: “Nëse kishte mbetur kanali i hapur, atëherë ishte dashur ta rrethojmë. Ndodh vetëm tek pusetat kryesore, ku kemi punuar në terren për tri dalje; aty na ka marrë kohën që ishte dashur për ta betonuar dhe ta rrethojmë. Kjo pjesë çdo ditë gërmohet dhe vendoset gypi, dhe në të njëjtën kohë edhe mbulohet. Ndodh që edhe njerëzit marrin gypin me vete.”

¹³ Takimi i ekipit të Auditimit Social me Menaxheren e Kontratës_Diellza Bajraktari_24.09.2025

¹⁴ Diellza Bajraktari_Menaxhere e Kontrates së Ujësjellësit_Faza 2_11.11.25

Menaxherja e Kontratës, Diellza Barjaktari, ka sqaruar arsyen e mungesës së rrethojave. “Natyra e punimeve në shtrimin e rrjetit të ujësjellësit e pamundëson rrethimin e punishteve në strukturë të fortë për çdo segment. Shtrirja e gypit në kanale, bëhet në prezencë të punëtorëve të kompanisë dhe mbyllja e kanaleve bëhet në çast që domethënë që punimet e një segmenti fillojnë edhe përfundojnë në çast. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal është i vendosur gjatë gjithë segmentit që punohet.”¹⁵

Kompania punëkryese “Diamanti” Sh.PK vlerëson lart angazhimin e ekipit për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e standardeve të zbatimit dhe e ka falënderuar ekipin për rekomandimet dhe bashkëpunimin; dhe u shprehën të gatshëm të bashkëpunojnë jo vetëm në këtë projekt por edhe në të tjera, ku kompania e tyre zhvillon punime.



Dëmtime në rrugë pas punimeve në ujësjellës

Ekipi ka identifikuar se në pjesët ku janë realizuar kyçjet në ujësjellës është prerë asfalti apo edhe rruga me kubëza. Me kalimin e kohës, toka ka zbritur dhe kjo po shkakton vështirësi në qarkullimin me automjete të banorëve, por edhe të hynë apo dalin nga shtëpitë e tyre, të cilët kanë shprehur ankesa lidhur me këtë dukuri. Ekipi rekomandon që Operatori Ekonomik të sanojë sa më parë dëmet e shkaktuara gjatë punimeve. Kjo çështje është ngritur edhe në takim me Menaxheren e Kontratës dhe në Komunë. Në vizitën pasuese ekipi ka evidentuar se ka filluar sanimi rrugës në disa pjesë.

Menaxherja e kontratës në Komunën e Drenasit ka thënë se sanimi i dëmeve është i paraparë me kontratë. “Në paramasë është i paraparë pozicioni për prerjen e asfaltit si dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme”¹⁷.

Operatori Ekonomik “Diamanti” ShPK në përgjigjen drejtuar ekipit të Auditimi Social, jep këtë sqarim “Sa i përket vërejtjes për mungesën e rrethimit të vendpunishtes, dëshirojmë të sqarojmë se rrethimi me strukturë të fortë nuk është i realizueshëm në të gjitha pjesët e terrenit për shkak të natyrës së punimeve ndërsa hapja dhe mbyllja e kanaleve bëhet në çast në prezencë të punëtorëve të kompanisë. Megjithatë, ne jemi plotësisht të vetëdijshëm për rrezikun që paraqet ky aspekt dhe, në çdo rast, vendosim shenjat e komunikacionit, konet dhe shiritat sinjalizues për të siguruar sigurinë e vendpunishtes”.¹⁶

Nga vizitat në teren të ekipit është parë që në disa rrugë në fshatin Dobroshec, ku është dëmtuar asfalti për shkak të instalimit të ujësjellësit në fazën e parë të projektit, janë rregulluar.

Ndërsa Menaxherja e Kontratës thotë se kur të përfundojë komplet projektin, do të fillojë me asfaltimin. Nuk mund të asfaltohet çdo rrugë që prehet, sepse është edhe njëfarë procedure e gjatë.

Edhe Operatori Ekonomik punëkryes zotohet se do të sanojë dëmet. “Sa i përket prerjes së asfaltit dhe largimit të kubëzave në zonat ku janë kryer kyçjet në ujësjellës, ju informojmë se punimet janë ende në zhvillim dhe në përputhje me planin dinamik. Për çdo pjesë të përfunduar, bëjmë përmirësimin e trasësë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë këtë deri në përfundimin e projektit, kur do të realizohet kthimi i asfaltit dhe kubëzave në gjendjen e tyre të mëparshme.”¹⁸

¹⁵ Diellza Bajraktari_Menaxhere e Kontrates së Ujësjellësit_Faza 2_11.11.2025

¹⁶ Operatori Ekonomik_Diamanti ShPK_30.10.2025

¹⁷ Diellza Bajraktari_Menaxhere e Kontrates së Ujësjellësit_Faza 2_11.11.25


¹⁸ Operatori Ekonomik_Diamanti ShPK_30.10.2025



Mospërfshirja e hershme në planifikim dëmton investimet e ekzistuese

Në projektet e infrastrukturës, si ky dhe të tjera të ngjashme, ekipi konstaton se janë rezultat i mosplanifikimit me kohë dhe si duhet, duke shtuar këtu edhe mospërfshirjen e hershme të komunitetit. Andaj ekipi ka rekomanduar që në të ardhmen infrastruktura duhet të shtrihet paraprakisht. Aty ku dihet që do të shtrihet ujësjellësi, gypat të vendosen para asfaltimit të rrugës, në mënyrë që të shmanget nevoja për prerjen e asfaltit më pas.

Tutje, para planifikimit të projekteve, Komuna e Drenasit të kontaktojë me qytetarët dhe të kërkojë nga ta se ku kanë nevojë të kenë kycje të tjera. Pra ekipi rekomandon që para fillimit të çdo projekti, të diskutohet paraprakisht me banorët e zonës dhe të paracaktojë me kohë vendkyçjet në zonat ku mund të ndërtohen shtëpi të reja.



Rrezikohet dëmtimi i gypit të ujit nga rrjedhja e fuqishme e lumit

Ekipi ka identifikuar një problem të mundshëm dhe me rrezikshmëri të lartë, lidhur me gypin që trupon lumin. Fillimisht, gypi ishte në gjendje të mirë dhe i dukshëm, por tani nuk shihet më.

Ndërkohë, lumi në fshatin Dorboshec nga banorët thuhet se ka dëmtuar pesë ura, gjë që përbën një rrezik serioz për infrastrukturën dhe sigurinë në zonë. Andaj ekipi rekomandon të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë çështje.

Gjithashtu, ekipi rekomandon që projekti duhet të zhvillohet sipas planit zhvillimor të Komunës së Drenasit.

Sipas Menaxheres së Kontratës, në një pjesë në Drenas ku lëvizin edhe persona me karroc pritet të shtrohet rruga. “Para se të shtrohet rruga, e kemi kryer instalimin në dakordim me stafin tonë. Ndërsa për rrugët që janë shtruar më herët, nuk kemi pasur mundësi pa bërë deportim, ose me pre asfaltin.”

Menaxherja e Kontratës, Diellza Bajraktari, për këtë ka deklaruar se planifikimet bëhen bazuar në gjendjen reale të terrenit ndërsa dëmtimet që shkaktohen, sanohen dhe rregullohen në çast nga operatori ekonomik.¹⁹

Nga Komuna vlerësohet si vërejtje me vend e ekipit dhe shumë e rëndësishme. Gypi duhet ose të zëvendësohet me një gyp metalik, ose të identifikohen pjesët ku shpejtësia e ujit është më e ulët.

Në lidhje me problemin e evidentuar me gypin që trupon lumin, sqaron se në fshatin Dobroshec kompania e tyre ka zhvilluar vetëm punimet e kyçjeve shtëpiake, me projektin e fazes së I-rë, dhe këto punime në gypin kryesor nuk janë ekzekutuar nga kompania jonë.




Kërkohet të mos ketë vonesa në testimin e gypave

Ekipi i Auditimit Social evidenton se banorët kanë kërkesa për përsheptimin dhe pa vonesa të testimit të gypave në vendet ku janë përfunduar punimet, pasi kanë nevojë që të kryejnë rregullimet në oborret e shtëpive të tyre, si pasojë e punimeve të kyçjeve. Testimi i gypave është i domosdoshëm për të mundësuar këto ndërhyrje në mënyrë të sigurtë dhe pa probleme.

Nga Komuna thonë se testimi i gypave duhet të bëhet në bashkëpunim me KRU Prishtina - Drenas. Sipas tyre, nuk mund të bëhet testimi pa qenë rezervuari me ujë. Komuna e Drenasit ka thënë se është kompetencë e tyre, dhe do të caktojnë një ditë kur mund të testohet në komplet fshatin.

¹⁹ Diellza Bajraktari_Menaxhere e Kontrates së Ujësjellësit_Faza 2_11.11.2025



Dy lagje në fshatin Dobroshec jashtë sistemit të ujësjellësit në mungesë të gypit kryesor

Gjatë vizitës në terren dhe në komunikim me banorët e zonës, ekipi konstatoi se për arsye të ndryshme Lagjja Shehu dhe disa shtëpi pranë Stacionit të Trenit në këtë fshat kanë mbetur jashtë sistemit të ujësjellësit, për shkak të mungesës së gypit kryesor, nga faza e parë e projektit.

Ekipi rekomandon që në fazën e dytë të projektit t'u ofrohet zgjidhje edhe këtyre lagjeve, dhe njëkohësisht të evitohen raste të tilla në të ardhmen.

Lidhur me këtë çështje, Menaxherja e Kontratës deklaron: “Te pjesa e Korreticë të Epërme, që nga fillimi nuk kemi pasur as pengesa dhe as defekte, te pjesa e Dobroshecit janë dy rrjeta: njëra është prej CDI-së, që po mundohemi ta shfrytëzojmë, dhe tjetra është vendosur më herët nga Komuna e Drenasit”²⁰

Një pjesë e madhe ka ujë, dhe Menaxherja Bajraktari zotohet se po mundohen që banorët apo shtëpitë që i përkasin këtij gypi që ka ujë, t'i lidhin në rrjet, dhe rrjetin tjetër ta lidhin me lagjet tjera.

Lidhur me rekomandimin se disa lagje në fshatin Dobroshec kanë mungesë të ujit, menaxherja e kontratës ka thënë se lagjet në fshatin Dobroshec janë pjesë e projektit për fazën e parë në ndërtimin e kapacitetit të ujësjellësit, të cilat janë në implementim dhe nuk përfshin projektin e fazës së dytë të ndërtimit të kapacitetit të ujësjellësit.”

KAPITULLI III

GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI I RRUGËS DHE NDËRTIMI I TROTUARIT NË ARLLAT-NEGROC DHE VUÇAK”

Ekipi i Auditimit Social ka vizituar edhe rrugën ku parashihet të bëhet rehabilitimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc dhe Vuçak, dhe ka evidentuar çështjet e mëposhtme. Nevoja për planifikim të qasjes për personat me aftësi të kufizuar.

Gjatë inspektimit të projektit aktual, ekipi ka konstatuar se infrastruktura e realizuar nuk ofron qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar. Trotualet janë të ngushta, me nivelime dhe disnivele që e bëjnë të vështirë lëvizjen e këmbësorëve që përdorin karroca, si dhe për personat me shikim të kufizuar. Përveç kësaj, nuk janë vendosur pjerrinat e nevojshme për rampa, ndërsa shiritat orientues për personat e verbër mungojnë plotësisht, duke e bërë qasjen në rrugë dhe hapësira publike të paqasshme dhe jo të sigurta.

Evidentimi i këtyre mangësive nënvizon nevojën që projektimi i projektit të ri të jetë 100% i përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar. Kjo përfshin ndërhyrje të plotë për të siguruar trotuare të qasshme dhe familjare, me pjerrina të standardizuara, shiritat orientues për personat e verbër dhe sipërfaqe të rregullta për lëvizje të sigurtë. Sigurimi i këtyre elementeve është thelbësor për respektimin e

ligjeve dhe standardeve për qasjen universale dhe për garantimin e të drejtës për lëvizje të lirë dhe të sigurtë për të gjithë qytetarët.

Përveç trotuareve, është e domosdoshme që projekti të përfshijë edhe parkingje të përshtatura për personat me aftësi të kufizuar, të vendosura në vende strategjike pranë objekteve publike dhe atraksioneve. Këto parkingje duhet të kenë dimensione të mjaftueshme dhe sinjalistikë të qartë, duke garantuar qasje të lehtë dhe të sigurtë për përdoruesit, dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe përvojës së qytetarëve në hapësirat publike.

Në përmbledhje, projektimi i projektit të ri duhet të marrë parasysh të gjitha elementet që bëjnë një hapësirë publike të qasshme dhe të sigurtë për personat me aftësi të kufizuar, duke përfshirë trotualet, pjerrinat, shiritat orientues për personat e verbër dhe parkingjet e përshtatura. Një qasje gjithëpërfshirëse dhe e kujdesshme në këtë drejtim jo vetëm që përmirëson cilësinë e infrastrukturës, por edhe garanton respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe integrimin e tyre të plotë në komunitet.






Rrezik për kontest pronësor në ndërtimin e trotuarit

Nga të dhënat për projektin, ekipi ka vërejtur se trotuari pritet të jetë 1.20 m dhe ka identifikuar që në segmentin ku pritet të ndërtohet trotuari, janë edhe prona private, dhe mund të paraqesin pengesa që rrezikojnë të dështojnë. Andaj ekipi rekomandon që

komuna t'i evitojë paraprakisht këto probleme. Njëkohësisht nevojitet që trotuaret të jenë të përshtatshme për personat me karroca, duke përfshirë ndërtimin e pjerrinave ku është nevojshme.



Ura rrezikohet nga vërshimi, nevojitet thellimi i saj

Gjatë vizitës në terren, tek ura në rrugën Negroc–Vuçak, ekipi ka vërejtur një rrezikshmëri të mundshme nga vërshimet, sidomos gjatë reshjeve të mëdha. U konstatua se hapësira nën urën ekzistuese është e pamjaftueshme për të përballuar rrjedhën e

shtuar të ujit. Për këtë arsye, u propozua që të rritet thellësia nën urë, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i bllokimit të rrjedhës dhe të parandalohet përmybtja e rrugës dhe zonave përreth.



Mungon vendndalimi për autobus

Ekipi i Auditimit Social ka evidentuar se në këtë pjesë mungon një vendndalim për autobusë, ndonëse në këtë zonë ka nxënës që udhëtojnë çdo ditë me autobus për në shkollën që lidh

këto dy fshatra Negroc-Vuçak. Për këtë arsye, ekipi e konsideron të domosdoshme ndërtimin e një vendndalimi për autobusë në afërsi të shkollës.



Një pjesë e rrethojës së shkollës paraqet pengesë për lëvizjen e nxënësve

Ekipi i Auditimit Social ka konstatuar se një pjesë e rrethojës së shkollës, e vendosur pranë rrugës, po pengon lëvizjen e nxënësve; për këtë

arsye ekipi rekomandon zhvendosjen e saj në një distancë të përshtatshme.



Nevojiten vija të bardha dhe ato dridhëse afër shkollës

Ekipi ka vlerësuar se është e nevojshme që në asfaltin afër hyrjes së shkollës të vendosen vija të bardha për kalimin e këmbësorëve, dhe para


tyre të vendosen vija me teksturë dridhëse në mënyrë që të detyrojnë pjesëmarrësit në komunikacion të ngadalësojnë shpejtësinë.



Mungon tabela për pjerrtësinë e terrenit

Ekipi i Auditimit Social në Drenas nuk gjeti ndonjë tabelë të vendosur për pjerrësinë e terrenit, prandaj rekomandoi të bëhet testimi i


pjerrtësisë së terrenit dhe vendosja e tabelës përkatëse në afërsi të rrugës.



Numër i vogël i sinjalistikës rrugore

Në terren është vërejtur një numër i vogël i tabelave sinjalizuese vertikale përgjatë kësaj rruge qarkulluese. Bazuar në këtë, ekipi rekomandon të kryhet një vlerësim i përshtatshmërisë së shpejtësisë në këtë zonë

dhe, në bazë të rezultateve, të vendosen shenjat përkatëse që do të rregullojnë qarkullimin në mënyrë më efektive dhe të sigurtë.



Rrezik për kalimtarët, mungojnë rrethojat mbrojtëse pranë urës

Ekipi gjeti se përgjatë rrugës dhe në afërsi të urës mungojnë rrethojat mbrojtëse. Kjo krijon rrezik potencial për kalimtarët dhe përdoruesit

e rrugës. Për këtë arsye, rekomandohet vendosja e rrethojave mbrojtëse afër urës.



Pronat private si pengesë për ndërtimin e trotuarit

Ekipi i Auditimit Social evidentoi se në disa segmente të rrugës, ku parashikohet ndërtimi i trotuarit, trojet përkatëse ndodhen në pronësi private. Kjo situatë mund të sjellë sfida në procesin e shpronësimit dhe potencialisht të


ndikojë në zbatimin e projektit. Për rrjedhojë, ekipi rekomandon që të shqyrtohen zgjidhje të përshtatshme për të shmangur problemet pronësore.



Nevoja për shporta të mbeturinave përgjatë trotuarit

Duke qenë se kjo rrugë është e frekuentuar nga qytetarët, ekipi e sheh të nevojshme vendosjen e shportave për mbeturina përgjatë trotuarit, si masë për mbrojtjen e ambientit dhe ruajtjen


e pastërtisë publike. Kjo do të ndihmojë në reduktimin e ndotjes, do të inkurajojë sjellje të përgjegjshme nga kalimtarët.



Kryqëzim i rrezikshëm pa sinjalistikë në Vuçak

Ekipi gjen se kryqëzimi i rrugëve në pjesën ku përfundon rruga e projektit në Vuçak është më se i rrezikshëm dhe nuk ka sinjalistikë adekuate që të rregullojë qarkullimin në mënyrë të sigurtë. Andaj rekomandohet vendosja e

tabelës adekuate në udhëkryq, po ashtu edhe tabela e cila tregon vendbanimet (fshatrat) që lidhin këto rrugë, për të orientuar drejtuesit e mjeteve dhe për të rritur sigurinë.



Ngushtimi i rrugës pamundëson shtrimin e trotuarit

Në pjesën e fundit të rrugës ku edhe përfundon ky projekt, në fshatin Vuçak, ekipi ka evidentuar se rruga ngushtohet dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e trotuarit. Si pengesë kryesore janë identifikuar pronat private që kufizojnë zgjerimin e rrugës.

Ekipi rekomandon që Komuna të zhvillojë diskutime me pronarët e parcelave përreth dhe të shqyrtojë mundësinë e një ndërhyrjeje të përshtatshme, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje që do të mundësojë vazhdimësinë e trotuarit dhe rritjen e sigurisë për këmbësorët.



Testimi i kapacitetit mbajtës dhe vendosja e tabelës së tonazhit

Pas përfundimit të punimeve dhe rregullimit të rrugës, Komuna e Drenasit duhet të kryejë një vlerësim teknik (test) të kapacitetit mbajtës të rrugës, për të përcaktuar tonazhin maksimal që ajo mund të përballojë pa u

dëmtuar. Bazuar në rezultatet e këtij testimi, rekomandohet vendosja e tabelës për tonazhin e lejuar të automjeteve, me qëllim mbrojtjen e infrastrukturës rrugore dhe garantimin e sigurisë në qarkullim.



KAPITULLI IV

GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “INSTALIMI I PANELEVE SOLARE NË KULMIN E OBJEKTIT TË KOMUNËS”

Instalimi i paneleve solare ne kulmin e objektit të Komunës së Drenasit ishte nevojë dhe kriter që objektet instiucionale të jenë me këtë formë standarde të energjisë solare.

Për këtë qëllim, Komuna e Drenasit kishte iniciuar procedurë tenderuese përmes njoftimit për kontratë të datës 03.09.2025. Kontratën në vlerë 17,812.32 euro Komuna e Drenasit e lidhi me Operatorin Ekonomik “Eda Solution Sh.P.K” më 14.10.2025.

Projekti parasheh instalimin e një sistemi solar fotovoltaiik me kapacitet 55.68 kwp, duke përfshirë 96 panele monokristaline me efikasitet të lartë dhe një inverter trefazor 50 kw me pajisje për monitorim online. Përveç pajisjeve kryesore, përfshihet edhe infrastruktura mbështetëse si kabllot, lidhësit, strukturat metalike dhe mbrojtjet elektrike për pjesën AC dhe DC. Gjithashtu, kontraktori do të kryejë instalimin, testimin dhe komisionimin e sistemit sipas standardeve ndërkombëtare, si dhe do të merret me licensimin pranë KEDS-it. Projekti përfundon me dorëzimin e dokumentacionit teknik dhe trajnimin e stafit komunal për operim dhe mirëmbajtje të sistemit.

Meqenëse gjatë kohës, kur anëtarët e ekipit kanë monitoruar projektet e Granitit për Përfomancës Komunale, projekti në fjalë ka qenë në fazën kontraktimit dhe jo atë të implementimit të kontratës, ekipi realizoi një takim me përfaqësuesit e Komunës me datë 06.11.2025, për të diskutuar për projektin.

Në çështjen se si po implementohet e monitorohet kontrata, ekipi mësoi se monitorimi i kontratës është duke u bërë sipas standardeve, dhe është duke u respektuar kontrata. Komuna njoftoi po ashtu se në hyrje të pobjektit është vendosur panoja në të cilën tregohet se janë duke u kryer punimet.

Shefi i i sektorit të Shërbimeve Publike, Afrim Prokshi, i ka ofruar edhe dëshmi ekipit të Auditimit Social dhe kështu ekipi ka konstatuar se janë respektuar kërkesat e dalura nga kontrata.

Lidhur me rrezikun e qasjes së personave të tjerë në hapësirat e punimeve të këtij projekti, në takimin e datës 06.11.2025, por edhe në përgjigjen me shkrim nga Komuna e Drenasit, janë deklaruar se asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të këtë qasje, përpos personave të caktuar.

Një çështje tjetër e ngritur nga ekipi i Auditimi Social kishte të bënte me sigurinë e punëtorëve dhe pajisjet mbrojtëse. Në takim me komunarët u tha se punëtorët janë pajisur me pajisje mbrojtëse. Edhe në përgjigjen me shkrim së bashku me dëshmitë e ofruara thuhet “OE, është duke i përdorur masat mbrojtëse gjatë implementimit të projektit”²¹

Në bazë të përgjigjeve dhe dëshmime të ofruara, ekipi konstaton se janë respektuar kriteret e sigurisë për punëtorët.

²¹ Afrim Prokshi_Shefi i sektorit_Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë_13.11.2025



Një çështje tjetër e ngritur nga ekipi kishte të bënte me verifikimin e pajisjeve dhe paneleve të tjera se a janë me certifikata cilësie dhe me garanci nga prodhuesi. Afrim Prokshi në takimin e datës 06.11.2025 tha se nga Operatori Ekonomik janë kërkuar certifikatat e cilësisë. “Ne paraprakisht kemi kërku nga operatori me i sjellë certifikatat qysh i kemi pasë në projekt dhe konform cilësisë që i ka pasë në paramasë edhe i ka vendosë.”²²

Në përgjigjen me shkrim së bashku me dëshmitë e ofruara nga Komuna e Drenasit thuhet se Operatori Ekonomik është duke përdorur materialin konform specifikave që i ka në paramasë.

Bazuar në të dhënat e ofruara, ekipi konstaton se komuna ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në këtë drejtim.

Një pikë tjetër që ekipi i Auditimit Social ngriti në lidhje me këtë projekt, kishte të bënte me mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e sistemit

të paneleve diellore. Ata kanë kërkuar që të trajnohet stafi komptent për to, të hartohet një plan i mirëmbajtjes afatgjatë për të garantuar funksionimin efikas dhe jetëgjatësinë e sistemit. Nga komuna kanë thënë se është paraparë edhe në paramasë që do të jetë mirëmbajtja e komplet sistemit të paneleve solare për tri vite nga Operatori Ekonomik.

Ndonëse pajisjet janë vendosur, kyçja në sistem nuk mund të jetë e mundur pa një pëlqim paraprak nga ZRRE dhe KEDS, për të cilin po merret punë kryesore. “Operatori në Paramasë e ka marrjen e pëlqimit nga ZRRE-ja dhe KEDS-i. Janë vendos pajisjet mirëpo ne nuk guxojmë me i kyçë pa pëlqimin e tyre.”²³

Projekti i instalimeve solare në këtë komunë konsiderohet ndër projektet më të mira. Nga Komuna e Drenasit kanë thënë se në kohëzgjatje prej tri vjetësh, Komuna e mbulon këtë investim, dhe pas tri vjetësh, në sezonin e verës do të kursehet deri në 70 % e energjisë.

²² Afrim Prokshi_Në takimin e Ekipit të Auditimit Social me përfaqësuesit e komunës_06.11.2025

²³ Afrim Prokshi_Në takimin e Ekipit të Auditimit Social me përfaqësuesit e komunës_06.11.2025

PËRFUNDIME / REKOMANDIME


Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve



- Gjatë hartimit të projekteve, Komuna duhet të promovojë diskutimin e tyre në fazën e planifikimit, ashtu siç rekomandon Udhëzimi Administrativ për Transparencën Komunale. Gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore dhe hartimit të dokumenteve, Komuna duhet të ofrojë arsytetime të detajuara për pranimin ose refuzimin e projekteve investive.
- Në të ardhmen, Komuna e Drenasit duhet të publikojë projektet në detaje, dokumentet e menaxhimit të kontratës, faturat e paguara, punët e kryera dhe të paguara, ndryshimet e kontratës dhe arsyetimin e këtyre ndryshimeve.
Komuna duhet të implementojë obligimin për vendosjen e tabelave informuese për projektet, duke bërë publik emrin e mbikëqyrësve të projekteve dhe kontaktet e tyre.
- Ndonëse komuna ka bërë përparime për të përfshirë më shumë gratë dhe personat me aftësi të kufizuar në dëgjimet dhe konsultimet buxhetore. Ekipi rekomandon që të avancojë tutje që pjesëmarrja e tyre të ndikojë direkt në vendimmarrje.



Rekomandimet për procesin e planifikimit të projektit




Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social grupi ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Komuna duhet të sigurohet që të gjitha projektet investive të zbatojnë 100% obligimet për sigurimin e qasjes së personave me aftësi të kufizuara.
- Procedurat e prokurimit të jenë në kohë, për të shmangur humbjen e fondeve nga donatorët dhe për të respektuar afatet e kontratave.
- Projektet të planifikohen për të garantuar qëndrueshmëri afatgjate dhe të shmanget nevoja për intervenime të reja.
- Projektet duhet të planifikojnë edhe trajtimin e faktorëve natyrorë si erozioni apo rreziku për rrëshqitje të dheut.



Rekomandimet për procesin e mbikëqyrjes së projektit



Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social, ekipi ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Mbikëqyrja e punimeve të jetë aktive dhe të sigurojë që puna të realizohet sipas projektit dhe standardeve.
- Sinjalistika rrugore duhet të ketë vëmendje të veçantë gjatë mbikëqyrjes.
- Vendosja e shenjave paralajmëruese dhe barrierave mbrojtëse në të gjitha vendpunishtet publike dhe rrugët ku zhvillohen punime.
- Vendosja e udhëzimeve të qarta për qytetarët dhe punëtorët mbi rreziqet potenciale në vendpunishtet.

METODOLOGJIA

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara nga intervistat, kërkesat për qasje në dokumente publike, vizitat në terren dhe bisedat me komunitetin. Në muajin korrik, DEMOS dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në standarde

të paracaktuara përzgjedhi 16 projekte në 6 komuna të Kosovës, të cilat do të përfshiheshin në procesin e Auditimit Social. Në kuadër të procesit të Auditimit Social u përfshinë 16 projekte në gjashtë komuna.

Emri i projektit	Komuna	Vlera	Faza e projektit në nisjen e auditimit
Asfaltimi i Rrugës Llapushnik-Berishë-Faza e dytë	Drenas	497,724.00 €	Implementim
Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas-Faza e dytë	Drenas	299,652.50 €	Implementim
Rehabilitimi rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc-Vuçak	Drenas	700,000.00 €	Tenderim
Instalimi i paneleve solare në kulmin e objekti të Komunës	Drenas	17,812.32 €	Tenderim
Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në Lokacionet - Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec	Kaçanik	241,111.11 €	Implementim
Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë Duraj	Kaçanik	260,885.45 €	Implementim
Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad	Dragash	80,299.82 €	implementim
Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës	Dragash	101,994.69 €	Implementim
Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit, Ndriçimi në rrugën unazore në Dragash	Dragash	135,329.28 €	Implementim
Asfaltimi e kubëzimi i rrugëve në fshatrat e Gorës (Restelicë dhe Radeshë)	Dragash	122,219.00 €	Tenderim
Ndërtimi i Shtratit të Lumit Istog dhe Ndërtimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë	Istog	Vlera e parashikuar e kontratës është 7,498,356 € (Shtrati i lumit) 301,155 € (rrugët)	Tenderim Implementim

Gjenerator dhe paisje elektrike për pastrimin e dyshemeve-për objektet komunale (administratë, arsim dhe shëndetësi)	Mamushë	52,333.66 €	Tenderim
Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)	Lipjan	59,925.88 €	Implementim
Ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së Krojmir	Lipjan	121,555.55 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Sllovi	Lipjan	267,381.95 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturovc dhe Ribar i Madh	Lipjan	266,715.00 €	Implementim

Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?

Grupi i Auditimit Social është një grup i qytetarëve të cilët në mënyrë vullnetare i përgjigjen nismës për t'u angazhuar në mbikëqyrjen e projekteve.

Me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të komunitetit, BIRN dhe D+ në bashkëpunim me OJQ-të lokale partnere të projektit, hartuan një listë me profesione dhe përfaqësues të komunitetit, të cilët janë ftuar për t'u bashkëngjitur në grup.

Në kriteret e përzgjedhjes u përcaktua se grupi synonte t'u jepte prioritet përfshirjes së kategorive të marginalizuara të shoqërisë siç

janë gratë, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet joshumicë. Synohej që grupi të kishte laramani të profesioneve dhe moshave me qëllim të garantimit të gjithëpërfshirjes.

Ekipet e OJQ-ve partnere të projektit nën fasilitimin e BIRN dhe D+ kontaktuan mbi 200 qytetarë nga 6 komunat për t'i ftuar ata që të bëhen pjesë e grupeve. Mbi 120 qytetarë nga komunat e synuara u bënë pjesë e grupeve.

Në Drenas u themelua grupi me mbi 20 qytetarë, të cilët kanë punuar në mbikëqyrjen e projekteve.

Si u grumbulluan të dhënat?

Për përpilimin e këtij raporti, ekipi i themeluar i Auditimit Social përdori disa teknika për të grumbulluar të dhënat.

Ekipi u angazhua për të kërkuar online të dhënat publike të komunës, ekipi hartoi një listë me pyetje për projektet dhe kërkoi informacione nga komuna, dërgoi kërkesa për qasje në dokumente publike dhe analizo dokumentet e pranuar nga Komuna. Për të dokumentuar gjetjet, ekipi realizoi vizita

në terren dhe zhvilloi takime me zyrtarët e Komunës së Drenasit.

Të dhënat në raport janë grumbulluar nga 22 anëtarët e ekipit të Auditimit Social dhe raporti është hartuar OJQ Handikos Drenas, me ndihmën dhe mbështetjen e ekipit të BIRN. Raporti është bërë publik pas adresimit të komenteve të pranuar nga Komuna e Drenasit.



Validimi i të dhënave

Ekipi i Auditimit Social në Drenas ka punuar në identifikimin e problemeve në projektet e që janë implementuar në këtë komunë për të shkruar raportin. Në takimet e mbajtura ekipi u dakordua për gjetjet sistematike në dy projektet dhe për gjetjet specifike të projekteve individuale. Ekipi u dakordua

edhe për rekomandimet e paraqitura në këtë raport. Pas strukturimit të gjetjeve ekipi është takuar me kryetarin e komunës dhe ka kërkuar komente nga komuna për gjetjet në raport. Para publikimit komuna ka pranuar raportin për komente eventuale.

Përbërja e ekipit

Përbërja e ekipit: **22 anëtarë.**



Drejtor shkolle; Student; Ekonomist; Handikos; Person me aftësi të kufizuara; Ergoterapeute; Përfaqësuese nga QPDG; Polic; Zjarrfikës; Shoqata e të Verbërve; Administrator i fshatit; Inxhinier i makinerisë; Mësuese; Psikologe; Përfaqësuese e Grupit avokues të Nënave të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara; Pensionist;

Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social

Gusht 2025	<ul style="list-style-type: none"> ● Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Komunën e Drenasit ● Publikimi i materialeve promovuese në rrjetet sociale
Shtator 2025	<ul style="list-style-type: none"> ● Trajnimi për OJQ-të lokale, partnere të projektit ● Targetimi dhe identifikimi i profileve që do të jenë pjesë e ekipit ● Përgatitja e listës me profilet e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social nga OJQ Handikos Drenas ● Zgjedhja e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social ● Dërgimi i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën e Drenasit ● Trajnimi i ekipit të Auditimit Social ● Krijimi i grupit në platformën e komunikimit Viber ● Pranimi i përgjigjeve dhe dokumenteve të kërkuara nga Komuna e Drenasit ● Trajnimi, diskutimi dhe analizimi i dokumenteve të pranuar nga komuna ● Vizita në terren e ekipit të Auditimit Social në projektet për monitorim ● Takimi i ekipit me Menaxherët e Kontratave, Diellza Bajraktari dhe Kushtrim Berisha ● Vizita e radhës në teren e ekipit të Auditimit Social
Tetor 2025	<ul style="list-style-type: none"> ● Takimi i ekipit të Auditimit Social për analizimin e të gjitha dokumenteve të pranuar nga Komuna e Drenasit ● Takimi me Drejtorin e Shërbimeve Publike, Nexhmedin Gruda, Koordinatorin nga ekipi komunal për Grantin e Performancës dhe i cili është edhe Shef i sektorit në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Afrim Prokshi; Menaxheren e Kontratës së Projektit të Ujësjetës, Diellza Bajraktari ● Vizita në teren nga ekipi i Auditimit Social ● Takimi i ekipit për dakordimin e gjetjeve dhe rekomandimeve finale në draftimin e raportit ● Vendosja e strukturës dhe përcaktimi i pikave të shkrimit të raportit ● Ndarja e detyrës për shkrimin e raportit për kryesuesin e ekipit të Auditimit Social, Behxhet Binaku nga OJQ Handikos ● Draftimi i raportit mbi gjetjet dhe rekomandimet e ekipit të Auditimit Social



EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË DRENAS

Nr.	Emri / Mbiemri	Profesioni / Funkzioni
1	Skender Bogiqi	Ekonomist
2	Vijona Berisha	Handikos - Drenas
3	Qëndresa Bajrami	Ergoterapeute - Handikos Drenas
4	Edisona Istogu	Përfaqësuese nga QPDG
5	Ramadan Kurrumeli	Polic i pensionuar
6	Laura Bytyqi	Përfaqësuese nga QPDG
7	Fehmi Krasniqi	Drejtor i SHFMU "Jusuf Gërvalla", Negroc
8	Ramiz Sopi	Përfaqësues i fshatit Llapushnik
9	Habib Tahiraj	Administrator/Drenasi 1
10	Gjevdet Krasniqi	Kryetar i fshatit Negroc dhe Vuçak
11	Teuta Haliti	Psikologe
12	Bujar Imeri	Inxhinier i makinerisë
13	Zekë Kluna	Administrator i fshatrave Poklek i Vjetër dhe Poklek i Ri
14	Fadil Prenku	Administrator i fshatrave Dobroshec dhe Godanc
15	Isuf Shishani	Zjarrfikës
16	Albulena Imeri	Mësuese
17	Laureta Kadishani	Studente
18	Murat Elshani	Administrator i fshatit Gllobar
19	Andiona Kajtazi	Përfaqësues e Grupit avokues të Nënave të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara
20	Sadete Fazliu	Prind i një fëmije me aftësi të kufizuara
21	Lumnije Cakiqi	Shoqata e të Verbërve, Drenas
22	Emin Cakiqi	Shoqata e të Verbërve, Drenas

LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË DRENAS

Të dashur qytetarë të Komunës së Drenasit, të nderuar bashkëpunëtorë dhe të respektuar miq të projektit “Auditimi Social”,

Është një nder dhe privilegj i veçantë që Komuna e Drenasit është pjesë e këtij projekti të rëndësishëm, të realizuar nga BIRN dhe DEMOS. Ky projekt shënon një hap të rëndësishëm përpara në përpjekjet tona për të promovuar transparencën, llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë në administratën tonë lokale, veçanërisht në sektorin e projekteve infrastrukturore që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve tanë.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Komuna e Drenasit ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për “Auditimin Social”, duke konfirmuar përkushtimin tonë institucional për përfshirje, transparencë dhe efikasitet në menaxhimin e projekteve publike. Në kuadër të këtij procesi janë identifikuar dhe analizuar projekte të realizuara nga Granti i Performancës Komunale, ku janë nxjerrë rekomandime të vlefshme për përmirësimin e mëtejshëm të planifikimit dhe zbatimit të investimeve publike. Ky nuk është rasti i parë që Komuna e Drenasit mbështet fuqishëm procesin e “Auditimit Social”. Përkundrazi, përfshirja jonë e vazhdueshme në këtë iniciativë dëshmon angazhimin tonë për të ndërtuar një administratë publike që dëgjon, bashkëpunon dhe merr vendime në interes të qytetarëve.

Një nga aspektet më të rëndësishme të “Auditimit Social” është përfshirja e qytetarëve në procesin e vlerësimit të projekteve komunale. Kjo nxit transparencë, rrit besimin e publikut dhe forcon partneritetin ndërmjet komunës, shoqërisë civile dhe komunitetit. Përmes këtij projekti, qytetarët tanë kanë pasur mundësi të shprehin mendimet, sugjerimet dhe shqetësimet e tyre, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e politikave lokale. Dua të theksoj se ky projekt ka ndihmuar gjithashtu në rritjen e kapaciteteve institucionale të komunës sonë, duke na mundësuar të zbatojmë standarde më të larta të qeverisjes dhe menaxhimit të projekteve publike.

Në emër të Komunës së Drenasit dhe në emrin tim personal, shpreh mirënjohjen dhe falënderimet më të sinqerta për partnerët tanë – BIRN dhe DEMOS – për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre të çmuar. Po ashtu, falënderoj qytetarët e Drenasit për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në këtë proces, i cili është thelbësor për ndërtimin e një kulture të qëndrueshme të transparencës dhe llogaridhënies.

Ne do të vazhdojmë të mbështesim dhe të zhvillojmë iniciativat e tilla që kontribuojnë në ndërtimin e një Drenasi më të zhvilluar, më transparent dhe me administratë të përgjegjshme ndaj qytetarëve të saj.

*Me respekt,
Ramiz Lladrovci
Kryetar i Komunës së Drenasit*

LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E DRENAS

Auditimi Social ishte një koncept i ri për ne, e kishim dëgjuar më parë, por nuk kishim njohuri të mjaftueshme rreth tij.

Pas trajnimit të zhvilluar nga BIRN dhe DEMOS, kuptuam qartë se sa i rëndësishëm është ky proces për forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Në kuadër të projektit të monitoruar në Komunën e Drenasit, përmirësimi i infrastrukturës publike dhe përshtatja e saj me nevojat e qytetarëve, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, ka qenë një shembull i mirë i bashkëpunimit mes komunitetit dhe institucioneve lokale.

Ndërhyrjet e bëra kanë treguar se kur qytetarët janë të informuar dhe të përfshirë, rezultatet janë më të qëndrueshme dhe më të dobishme për të gjithë. Gjithashtu, përmes procesit të Auditimit Social, janë identifikuar disa problematika që lidhen me planifikimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, si mungesa e elementeve të qasjes apo vendosja jo e duhur e infrastrukturës ndihmëse. Këto gjetje janë të rëndësishme për Komunën e Drenasit dhe kompanitë e kontraktuara, në mënyrë që projektet e ardhshme të planifikohen më mirë dhe të jenë plotësisht funksionale.

Ne besojmë se Auditimi Social ka qenë një proces tepër i vlefshëm për përmirësimin e bashkëpunimit mes qytetarëve dhe komunës. Shpresojmë që ky proces të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke u dhënë mundësi të gjithë qytetarëve të marrin pjesë aktive në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e projekteve publike në komunitetin e tyre.

Jemi krenarë që puna e grupit tonë në Drenas ka ndikuar pozitivisht në rritjen e ndërgjegjësimit dhe ka kontribuar që projektet e monitoruara të përmirësohen. Jemi të bindur se Auditimi Social do të vazhdojë të nxisë përfshirjen aktive të qytetarëve, si dhe transparencën dhe llogaridhënien në institucionet lokale.





Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige